

ELEMENTI I ÇRREGULLIMIT INFORMUES

1

Lajme të rreme – postime të bazuara në informacione të rreme, të përgatitura që të duken si lajme të vërteta me qëllim të mashtrimit për përfitime financiare ose ideologjike.

Dezinformatata (keqinformim) – informacion që është i pavërtetë, por jo i krijuar me qëllim për të shkaktuar dëm, informacione mashtrues ose të pasakta që njerëzit i ndajnë pa i njohur si të tilla sepse besojnë se janë të sakta.

2

3

Informacione keqdashëse – informacione që janë të bazuara në realitet, por qëllimi është dezinformimi aktiv, dhe përdoren për të shkaktuar dëm personit, organizatës ose vendit.

Manipulimi i fakteve – Nën manipulimin e fakteve nënkuptojmë raportin mediatik që përmban informacione të bazuara në fakte, por i interpreton në mënyrë mashtruese.

4

5

Spin – Zhvendosja e vëmendjes së publikut nga ndonjë përmbajtje tjetër ose fakt që në atë moment është në fokus dhe i rëndësishëm për qytetarët.

Raportimi i njëanshëm – Raportimet mediatike qëllimi i të cilave nuk është të transmetojnë një informacion të caktuar, por të paraqesin një person, grup ose institucion në dritë pozitive ose negative.

6

7

Reklamimi i fshehur – Përmbajtje promovuese që në vend të vendit të parashikuar për reklama, paraqitet si punë gazetareske, dhe jo e shërbimit të PR-it të klientit që reklamon.

Clickbait – Këto janë tituj sensacionalistë, të tepruar dhe të formuluar për të tërhequr përdoruesit për të klikuar.

8

9

Gjuha e urrejtjes – Kjo është një gjuhë e drejtuar kundër njerëzve, individëve ose grupeve, për shkak të asaj që janë, shpesh kundër atyre që janë tashmë të ndjeshëm për shumë arsye të tjera.

Propaganda – Një formë informacioni që transmeton mesazhe emocionale, dhe jo informuese. Zakonisht është më shumë manipulues sesa dezinformues.

10

11

Satira – Përdor lajme fiktive me qëllim të portretizimit satirik të realitetit.

Censura – Në kuptimin më të gjerë, nënkupton monitorimin dhe/ose kufizimin e lirisë së shprehjes.

12

13

Mizogjia dhe stereotipet gjinore – Përmbajtja përhap urrejtje kundër grave dhe paragjyqime të rrënjësura thellë kundër grave.

Paragjyqimet – Raportimi në mënyrë që të paraqitet një pamje e gabuar për një person ose grup të caktuar.

14

15

Teoritë konspirative – Kjo është një pjesë ose i gjithë raporti mediatik që jep një përshkrim të pavërtetë ose të pa verifikueshëm të një fenomeni, ngjarjeje ose personi, duke i paraqitur ato si pjesë ose rezultat i një plani të fshehtë ("konspiracioni").

Pseudoshkenca – Raporti mediatik që paraqet mendime, qëndrime, vlera ose gjetje të caktuara, që nuk janë marrë me metodën shkencore, si zbulime ose fakte shkencore.

16

17

Përmbajtje e ndryshuar – kur informacioni ose imazhi origjinal është ndryshuar për të mashtruar (p.sh. fotomontazhe, deepfakes janë përmbajtje video të ndryshuara).

